



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Syllabusi i lëndës: Menaxhimi i Proceseve biznesore

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i proceseve biznesore
Niveli:	Master – Informatikë biznesi
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3+0
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Semestri pranveror
Mësimdhënësit e lëndës:	Prof. Ass. Dr. Bashkim Nurboja
Detajet kontaktuese:	bashkim.nurboja@unhz.eu
Përshkrimi i lëndës	Menaxhimi i Proceseve Biznesore (MPB) është një bashkësi e koncepteve, metodave dhe mjeteve që i ndihmojnë organizatës të zbatojnë, masin dhe përmirësojë proceset nga fillimi deri në fund. MPB i ndërtuar në mënyrë efektive i ndihmon organizatës me qenë efektiv në koordinimin e aktiviteteve, në mënyrë automatike alokimin e detyrave të akterët e procesit dhe integrimin e shërbimeve në aplikacion. MPB është në rritje për arsye të mundësive për përmirësim të performances.
Qëllimet e lëndës:	Lënda i MPB synon të ndërtojë një urë midis teorisë dhe praktikës, duke u fokusuar në zhvillimin e një kuptimi të thellë të koncepteve dhe metodologjive të MPB. Studentët mësojnë të analizojnë dhe të identifikojnë mënyrat nëpërmjet të cilave proceset e biznesit mund të optimizohen për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin. Përmes një qasjeje që përfshin mendimin analitik dhe kritik, ata trajnohen për të njohur dhe trajtuar paefektshmëritë, si dhe për të propozuar zgjidhje inovative që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve organizative. Duke përdorur teknologji të avancuar dhe mjete të MPB, studentët zhvillojnë aftësinë për të modeluar,

	projektuar dhe zbatuar procese biznesi të efektive. Ata gjithashtu mësojnë rëndësinë e përshtatjes strategjike, duke u siguruar që çdo përmirësim i procesit kontribuon drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve strategjike të organizatës. Kursi thekson gjithashtu rëndësinë e menaxhimit të ndryshimit, përgjegjshmërisë etike dhe pajtimit me rregulloret.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje të: 1. vlerësoj efciencen dhe efektivitetin e një organizate nga perspektiva e proceseve, 2. ndërmer projektet që përmirësojnë proceset në biznese, 3. përcaktojnë rolin e teknologjisë për të përkrahur proceset, 4. dizajnon dhe ri-dizajnon proceset dhe rrjedhën e punës për të përmirësuar performancën 5. implementimin e projekteve për MPB		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	5	2	10
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	5	2	10
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10	1	10
Përgaditja përfundimtare për provim	1	10	10
Totali			125

Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Rast studimi apo detyrë lidhur me temën e ligjësuar		
Metodat e vlerësimit:	• Vijshmeria: 10% • Detyra në grupe 30 % (2 detyra) • Testi I: 25% • Testi II: 25% • Rasti i studimit: 20% - Ose • Provimi përfundimtar 60% • Projekt dhe prezantim 40%		
Literatura			
Literatura bazë:	▪ John Jeston (2022);Business Process Management: Practical Guidelines to Successful Implementations 5th Edition ▪ Marlon Dumas, Marcello La Rosa, Jan Mendling, Hajo A. Reijers,(2018), Fundamentals of Business Process Management ▪ James F. Chang (2006), BUSINESS PROCESS MANAGEMENT SYSTEMS Strategy and Implementation.		
Literatura shtesë:	▪ Hammer, M., & Champy, J. (1993). <i>Reengineering the corporation: A manifesto for business revolution.</i> New York, NY: HarperBusiness. ▪ Nurboja, Bashkim, <i>Public-Private partnership and its role in the quality of public service: Case Study Prishtina International Airport "Adem Jashari" and the cleaning company "Unity" in Mitrovica</i> 2022 UBT INTERNATIONAL CONFERENCE 2022		
Plani i dizajnuar i mësimit:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		

Java e parë:	Njoftim me syllabus; Hyrje në MPB
Java e dytë:	Llojet e MPB
Java e tretë:	Identifikimi i proceseve
Java e katërt:	Modelimi i proceseve
Java e pestë:	Analiza cilësore e proceseve
Java e gjashtë:	Analiza sasiore e proceseve
Java e shtatë:	Testi I
Java e tetë:	Ri-dizajnimi i proceseve
Java e nëntë:	Proceset – vetëdija e sistemeve informative
Java e dhjetë	Implementimi proceseve me modele
Java e njëmbëdhjetë:	Monitorimi i proceseve
Java e dymbëdhjetë :	MPB si mundësi për ndërmarrje
Java e trembëdhjetë:	Përfshirja e softuerëve në MPB
Java e katërmëdhjetë:	Prezantimet e Rasteve të studimit
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.

